



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27.01.2023

Kodi i ZRRE-së: V_1676_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2386_11_22** i dt.25.11.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **19.12.2022**.

në seancën e mbajtur më datë 27.01.2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin Ukë Dakaj nga Komuna e Prizrenit, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. **ZRRE/DMK_V_2386_11_22** i dt.25.11.2022.

Arsyetim

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 25.11.2022 ka marrë Vendim me nr. **ZRRE/DMK_V_2386_11_22** me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 17.10.2022 lidhur me kontestimin e korrigjimit nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr.5844286.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se korrigjimi nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022 është reale;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së **ZRRE/DMK_V_2386_11_22** i dt.25.11.2022 për konsumatorin Ukë Dakaj

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korrigjimi nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022 është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit



elektrik nr. 0041419 datë 15.02.2022; Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9905 datë 10.08.2022; korrigjimi nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022; Përgjigja e KESCO-s datë datës 17.10.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 01.11.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2386_11_22 i dt.25.11.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike si dhe listat e leximi gjeti se korrigjimi nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022 nuk është i saktë, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, me datë 15.02.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 5844286 me gjendje TL=55970 kWh dhe TU=46237 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20090432 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kane evidentuar se ndërrimi i njehsorit behet me kërkesë te KEDS dhe njehsori i ri vendoset ne shtyllë. Bazuar ne analizën e procesverbalit ZRRE konstaton se ekipet e KEDS-it nuk kane evidentuar se njehsori elektrik është i dëmtuar ne çfarëdo forme. Me datë 10.08.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 5844286 me gjendje te shpenzimeve TL=55970 kWh dhe TU=46236 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori urën e tensionit ne sistemin e fazës se dytë (S) e ka te dëmtuar. Ne brendi te njehsorit komisioni ka vërejtur se sistemi i fazës se parë(R) është i djegur dhe nuk regjistron energji elektrike, si pasojë e kësaj eshë per shkak se te gjitha sistemet e fazave e kanë përçuesin e zeros te përbashkët dhe sistemi i fazës së tretë(T) nuk regjistron energji elektrike, pavarësisht se bobina e tensionit ne këtë sistem është ne rregull, ne kushte te tilla njehsori elektrik regjistron energji elektrike per 66% me pak. Bordi i ZRRE bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se ne asnjë rast lexuesi nuk ka evidentuar qe njehsori elektrik është i dëmtuar ne çfarëdo forme përveç se në disa periudha ka evidentuar sugjerim per zhvendosje si dhe jete gjatësia e tejkaluar. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe me te hershme me njehsorin e vjetër elektrik nr. 5844286 dhe njehsorin e ri elektrik nr. 20090432 për periudha të njëjta kohore, Bordi i ZREE-së konstaton se ka ndryshim të shpenzimeve, ka rritje te shpenzimit pas ndërrimit te njehsorit elektrik nr. 5844286. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 5844286 për periudhën 03/2019 deri në periudhën 10/2019 është 427 kWh/muaj, periudhën 03/2020 deri në periudhën 10/2020 është 449 kWh/muaj, periudhën 03/2021 deri në periudhën 10/2021 është 433 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 20090432 periudha 03/2022 deri në periudhën 10/2022 është 812.5 kWh/muaj. Po ashtu bazuar ne analizën e rrjedhës se energjisë elektrike vërehet se shpenzimet e konsumatorit edhe me njehsorin e kontestuar nr. 5844286 nga periudha 12/2021 deri me datë 15.02.2022 kur edhe është bere ndërrimi i njehsorit ka ndryshim edhe me shpenzimet e njëjta te mëhershëm. Sipas rrjedhës se energjisë dhe listave vërtetohet se : në periudhën 12/2021 shpenzimi është 1,200 kWh/muaj, në periudhën 01/2022 është 1,016 kWh/muaj kurse diferenca per leximin e periudhës janar 2022(data e leximit 25.01.2022) deri me rastin e ndërrimit te njehsorit datë 15.02.2022 është 725 kWh kurse per periudhat e njëjta te me hershme: periudhën 12/2019 shpenzimi është 740 kWh/muaj, në periudhën 01/2020 është 480 kWh/muaj, periudhën 12/2020 shpenzimi është 512 kWh/muaj dhe në periudhën 01/2021 është 628 kWh/muaj

Me datë 29.08.2022 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9905 datë 10.08.2022 të njehsorit elektrik nr. 5844286 përmes korrigjimit nr. 54362DPZ-36232 ka bërë korrigjimin plotësues në vlerë 478.43€ duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 08/2021(9 ditë) deri ne periudhën 02/2022(21 ditë) duke ri faturuar faturat e kësaj periudhe per 66%. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar ne procedurat dhe kodet ne fuqi (Kodin e Matjes se OSSH)sipas se cilave ne rastet kur konstatohet se ka defekt ne sistemin



matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare kurse konsumatorët familjar/shtëpiak periudhën gjashtë mujore, por që bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit përkatësisht shpenzimeve nga periudha 12/2021 deri në ndërrimin e njehsorit elektrik datë 15.02.2022 me njehsorin nr.5844286 konsumatori nuk duhet të ngarkohet me korrigjim plotësues pasi që edhe kWh e korrigjuar për periudhën 08/2021(9 ditë) deri në periudhën 02/2022(21 ditë) nuk përputhën me shpenzimet aktuale të konsumatorit me njehsorin e ri.


Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e në veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0041419 datë 15.02.2022, procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9905 datë 10.08.2022 si dhe korrigjimin nr. 54362DPZ-36232 datë 29.08.2022 ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Ganj Buçaj, anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit Ukë Dakaj dhe
- Arkivit të ZRRE-së.